

27.01.2023
Ora 11:34

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaç, Znj. M. Koja,
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **S’ka prezent**
- **Te tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Atëherë, në seancën e sotme kemi për shqyrtim dy çështje në rendin e ditës. Kemi projektvendimin që lidhet me aktin për procedurat e akreditimit të vëzhguesve jo partiak dhe pika e dytë ka të bëjë me rregullat për raportimin financiar vjetor të partive politike. Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaç: Pika e parë e rendit të ditës është shtyrë nga mbledhja e kaluar pasi organizata KRIIK kishtë dërguar disa sygjerime dhe pasi i lexuam dhe i pamë sugjerimet mendojmë që janë me vend. Në çdo qendër votimi do të vendosim një tabelë ku do të informojnë personat që do të hyjnë te ai ambient, që ky ambient është

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.01.2023*

i vëzhguar nga kamerat. Gjithashtu edhe vëzhguesit, duke njohur edhe kuadrin Rregullator të Komisionit Qendror, të ligjit, do të vihet në dijeni që ky ambient do të survejohet nga kamerat dhe do të pranohet që të marrë pjesë të procesi i votimit, vëzhgimit.

Z. I. Celibashi: Nuk do të jenë pjesë e aktit?

Z. Y. Merkaj: Jo.

Z. I. Celibashi: Pra, këto janë veprime që do t'i bëjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por në këtë akt nuk do të bëjmë ndryshime, sepse nuk është vendi për t'i bërë këto ndryshime. S'ka lidhje me vëzhgimin, ose s'ka lidhje vetëm me vëzhgimin e kam fjalën, kështu është. Mirë atëherë dakord, miratojmë këtë projektakt sipas draftit të propozuar.

Vendimi nr. 19

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.01.2023*

27.01.2023
Ora 11:37

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaaj, Znj. M. Koja,
Znj. V. Ballgjini**

• **Parti Politike:** **S’ka prezent**

• **Te tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë të pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike.

Znj. V. Ballgjini: Edhe ky është një akt i mbartur nga mbledhjet e kaluara. Është shtyrë për arsye se nga organizata KRIIK kanë ardhur disa sygjerime lidhur me mënyrën e raportimit të partive politike për vitin kalendarik. Pasi kemi marrë në shqyrtim edhe sygjerimet e KRIIK-ut, akti është rishikuar edhe kemi marrë parasysh një pjesë të mirë të sygjerimeve të dhëna nga KRIIK. Siç është njohja e KQZ-së me njohjen e financierit që të vihet në dijeni Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.01.2023*

ndryshimin e financierit ashtu sikurse edhe raportimi i të ardhurave shpenzimeve për vitet të cilat korespondojnë edhe me vitin të cilin është bërë fushata zgjedhore do të jenë të detajuara në raportin vjetor të partive politike. Pjesa tjetër mbetet e pandryshuar. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Atëherë, nëse nuk kemi gjë tjetër e miratojmë projektaktin së bashku me ndryshimet e kërkuara nga organizata KRIIK. Kemi gjë tjetër? Nuk kemi. Mirë atëherë, seanca mbyllet. Ditë të mbarë!

Vendimi nr. 20

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

